



**Qeveria e Republikës së Maqedonisë  
Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural**

Në bazë të nenit 9 paragrafi 1 pika b nga Ligji për ratifikimin e Marrëveshjes mes Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane për rregullat për bashkëpunim në bazë të ndihmës financiare të EK të Republikës së Maqedonisë dhe realizimit të ndihmës sipas komponentit V ( IPARD) nga instrumenti për ndihmë paraqasëse ("Gz. zyrtare e RM" nr. 38/2016), në bazë të Pjesës II masa Investime në mjetet materiale për përpunim të produkteve bujqësore dhe produkteve të peshkut pika 11 nga Programi për shfrytëzim të mjeteve nga Instrumenti për ndihmë paraqasëse për zhvillim rural të Unionit Evropian (IPARD) për periudhën 2014-2020 ("Gz. zyrtare e RM" nr. 177/2016), dhe në bazë të nenit 6 nga Dekreti i mënyrës dhe procedurës për shfrytëzim të mbështetjes financiare të masave për zhvillim rural të financuara nga programi IPADR 2014-2020 ("Gz. zyrtare e RM" nr. 64/2016).

**Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural**

më 30 nëntor 2018 publikon

**THIRRJE PUBLIKEA nr.01/2018**  
për parashtrim të kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga  
IPARD Programi 2014-2020

1. Agjencia për mbështetje financiare për bujqësi dhe zhvillimin rural (në tekstin në vijim: Agjencia) si dhe institucioni kompetent dhe organi përgjegjës për realizim të Instrumentit për ndihmë paraqasëse për zhvillim rural të UE (IPARD) bën thirrje tek të gjithë subjektet fizike dhe juridike të interesuar nga Republika e Maqedonisë të parashtrorin kërkesa për shfrytëzim të mjeteve nga IPADR Programi 2014-2020 për masat në vijim:

**2. Investime në mjetet materiale për përpunim të produkteve bujqësore dhe produkteve të peshkut.**

2. Mbështetja financiare për këtë thirrje publike është e përbërë nga 75% mjete të siguruara nga Instrumenti për ndihmë paraqasëse për zhvillim rural të Unionit Evropian (IPARD) në pajtim me Marrëveshjen Financiare 2014-2020 dhe 25% mjete të siguruara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

3. **Mjetet financiare për kërkesë individuale** shpërndahen si mbështetje financiare të pakthyeshme (grant) në vlerë prej:

3.1. 50% nga vlera totale e shpenzimeve të pranueshme të investimeve për masën Investime në mjetet materiale për përpunim të produkteve bujqësore dhe produkteve të peshkut.

4. **Afati i fundit për parashtrim të ofertave është 14 janar 2019.**

5. **Mbështetja totale financiare në kuadër të kësaj thirrje publike është 13.178.668,00 euro ose 810.422.183,74 denarë.**

**6. Tërheqja e formularëve dhe udhëzime:**

Formularët e duhur nga "Kërkesa për shfrytëzim të mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020", si dhe "Udhëzime për shfrytëzuesit e mjeteve nga IPARD Programi 2014-2020", për çdo masë veç e veç e cila përmban të gjitha informacionet për kriteret, kushtet dhe pajtueshmërinë e projekteve dhe kushteve për financim dhe informata të tjera të cilat janë të nevojshme për përgatitjen e kërkesës për shfrytëzim të mjeteve nga IPADR Programi 2014-2020, Udhëzimi për përgatitjen e Planit të Biznesit, Udhëzimet për lëshim të dokumentacionit të duhur nga institucionet kompetente dhe informata tjera të dobishme në versionin elektronik mund të merren në ueb faqen e Agjencisë: [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk)

**7. Mënyra e parashtrimit të kërkesës:**

Aplikanti duhet të plotësojë dhe të parashtrorin Kërkesë për shfrytëzim të mjeteve nga IPADR Programi 2014-2020 për masë individuale, Plan të Biznesit i përpunuar në pajtim me Udhëzimin për përpunim të Planit të Biznesit i shoqëruar me dokumentacionin ashtu siç është theksuar në këtë thirrje publike.

Kërkesa e plotësuar për shfrytëzim të mjeteve nga IPADR Programi 2014-2020 së bashku me planin e biznesit dhe dokumentacionin e tërësishëm të duhur parashtrorin në zarf të mbyllur me shenjën në anën e përparme të zarfit në këndin e epërm të majtë "MOS E HAP" për shpalljen publike IPARD numër 01/2018 dhe theksimi i masës për të cilën parashtrorin kërkesa. Kërkesa mund të parashtrorin përmes postës si dërgesë me rekomandim ose personalisht në sportelin e Agjencisë.

**Vërejtje:** Për shkak të realizimit të kontrollit në teren nga ana e Agjencisë është e nevojshme që aplikuesi të mbanë me vete kopje nga dokumentacioni i tërësishëm i parashtruar deri tek Agjencia.

**Informata më të hollësishme në kontakt tel. (02) 3097-460 ose e-mail adresa: [ipardpa.info@ipardpa.gov.mk](mailto:ipardpa.info@ipardpa.gov.mk) ose në ueb faqen: [www.ipardpa.gov.mk](http://www.ipardpa.gov.mk).**